



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL - MINISTARSTVO ZA REGIONALNI RAZVOJ
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
HYRËSE / ULAZNA INCOMING
Nr./Br./No. <u>399</u>
Nr.faq / Br.str /No.pg. <u>01</u>
Data / Datum / Date <u>01 / 04 / 2021</u>
PRIŠTINË - PRIŠTINA- PRISTINE

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Zhvillimit Rajonal**  
**Ministarstvo za Regionalni Razvoj**  
**Ministry of Regional Development**

Prishtinë, datë, 01.04.2021

Në mbështetje të Nenit 53 (paragrafit 3) dhe nenit 80 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitet, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr.05/L-007, bazuar në nenin 8 dhe 16 të Rregullores Nr. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe Thirrjes Publike të MZHR-së së datës 11.02.2021 për mbështetje financiare të projekteve/programeve të OJQ-ve në avancimin e zhvillimit socio ekonomik rajonal të balancuar, si dhe Vendimin Nr. 282 të datës 03.03.2021, i ndryshuar dhe i plotësuar me Vendimin nr. 282/1 të datës 08.03.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të MZHR-së për Themelimin e Komisionit Vlerësues për vlerësimin e projekt-propozimeve të pranuara nga OJQ-të për mbështetje financiare publike në fushën e avancimit të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar, Komisioni vlerësues nxjerrë këtë:

### V E N D I M

Në përputhje me detyrat dhe asfatet e komisionit të përcaktuara në vendimin e lartpërmendur dhe duke u bazuar në Thirrjen Publike të datës 11 Shkurt 2021, Komisioni ka shqyrtauar dhe vlerësuar të gjithë dokumentacionin përkatës, të dorëzuar/dërguar nga OJQ-të në MZHR, ku sipas kritereve Komisioni vlerësues ka shpallur fituesit që kanë aplikuar për objektiven:

**2.1. Promovimi i Zhvillimit Socio-Ekonomic Rajonal të Balancuar:** OJQ "Qendra për Hulumtime Psiko-Sociale, dhe Mjeksore (QHPSM)", OJQ "Riveristes - RVS", OJQ "Iniciativa Rinore Aktive - IRA", OJQ "Instituti për Ekonomi të Tregut të Lire", OJQ "OAPA", OJQ "Monumenta", OJQ "ICHAT", OJQ "Liberal Democrat Centre - LDC", OJQ "AZHR-Jug", OJQ "AZHR-Veri", OJQ "AZHR QENDER", OJQ "AZHR- Perëndim", OJQ "AZHR-LINDJE", OJQ "Perspektiva energjetike", OJQ "Forumi për Leadership dhe Diplomacy", OJQ "Feminae AGF", OJQ "Për Hulumtime Juridike dhe Sociale-OMNES.

**2.2. Nxitja e rrjetëzimeve me qellim të zhvillimit socio - ekonomik rajonal:** OJQ "Vullnetarizmi në Kosovë -VNK", OJQ "Dielli I Hapur", OJQ "People First - Pef", OJQ "Qendra EduKative Kulturore-KS , OJQ "Qendra e Rinis të Kaçanikut Aktiv", OJQ "HRK-DNK", OJQ "Kosova in EU", OJQ "Advocacy and Empowerment of the Youth in Kosovo AEYK"

**2.3. Nxitja dhe vetëdijesimi i të rinjve në fushën e zhvillimit socio-ekonomik:** OJQ "Wake up Woman", OJQ "Gruaja Ashkane për Gratë Ashkanlike - GAGA", OJQ "REISI", OJQ "Natural Fresh" OJQ "Me dorë në Zemer", OJQ "North Innovation Center - NIC", OJQ "Research -RCH".

## A R S Y E T I M

Komisioni brenda afatit të përcaktuar me Planin e veprimit ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni.

Në fazën e parë në bazë të kritereve formale nga njëqind e tre (103) aplikacione, kriteret formale i kanë plotësuar gjashtëdhjetë e tetë (68) prej tyre.

Në fazën e dytë të vlerësimit nga gjashtëdhjetë e tetë (68) aplikacione, prej tyre tridhjet e gjashtë projekt-propozime, nuk kanë plotësuar kriteret e fazës së dytë (vlerësimit përmbajtjesor) për të fituar financimin nga MZHR: (OJQ-të që nuk kanë kaluar fazën e dytë, janë të rënditura si më poshtë):

OJQ " D&D Business Support Center", OJQ – "DITA", OJQ - " Prishtina REA", OJQ "TOWN", OJQ "Shtëpia ime e drejtë ime", OJQ "Tourism and Marketing Institute - TMI", OJQ "OSFK", OJQ "Shoqata e Bujqeve Agro Dardana", OJQ "Nisma për Rini dhe Inovacion -NRI", OJQ "Instituti për Politika Ekonomike Lokale", OJQ "Qendra për Hapat Rinor", OJQ "Qendra për rini të avancuar", OJQ "Centar Gradanskë Inicjativa -CGI", OJQ "Qendra për Edukim Reforma", OJQ " Qendra për Shoqëri Civile në Prishtinë - QSHCP", OJQ "Advoncy for Society Devolpment -AFSD", OJQ "Bussines Marketing Training Centre - BMTC", OJQ "Bota e Rinisë", OJQ "Creative Center", OJQ "Change Lab Kosovo", OJQ "Zana", OJQ "JUVENUE", OJQ "SH.B ANAMORAVA, OJQ "Rrenjet Tona", OJQ "CECD- Frends", OJQ "Gratë e Minatorëve", OJQ "Vizionida", OJQ "KGBTD", OJQ "Qendra Rinore Publike Skenderaj", OJQ "GHS", OJQ "LDA Albania", OJQ "Youth Center Lipjan", OJQ "Bussines Women Mitrovica ", OJQ "Forumi për Shoqëri Civile-Mitrovicë", OJQ "Liza-R", OJQ "Merkuri".

Në përputhje me detyrat dhe afatet e komisionit të përcaktuara me planin e punës të miratuar nga të gjithë anëtarët e komisionit, Komisioni ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin përkatës, duke vlerësuar se cilin projekt - propozim veç e veç sipas Thirrjes Publike të datës 11 Shkurt 2021.

Komisioni ka pasur parasysh Rregulloren mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, rregullat e punës si aneks i kësaj rregulloreje dhe Thirrjen Publike nga MZHR të datës 11 Shkurt 2021.

Afati i OJQ-ve për aplikim për dorëzimin e projekt-propozimeve ishte nga data 11 Shkurt deri më 03 Mars 2021.

Sipas Thirrjes Publike, kriteret e përcaktuara ishin të ndara në ato të përgjithshme dhe të veçanta, si më poshtë:

### **Kriteret e përgjithshme:**

Për të qenë e pranueshme për këtë thirrje organizata aplikuese duhet të:

- Jetë e regjistruar në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare.
- Jetë e pajisur me numër fiskal – të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovë.
- Ketë zotësi juridike, financiare dhe operacionale për zbatimin e projektit.
- Ketë përvojë dhe veprimtari në fushën e qeverisjes lokale.
- Ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme.
- Mos jetë në proces falimentimi, në proces të shuarjes, në procedura të mbledhjes së detyrues apo likuidimit.
- Mos ketë shkelur kushtet e parashikuara të përdorimit të fondeve publike.
- Mos të ketë pranuar mjete financiare për të njëjtin aktivitet gjatë këtij viti. Prandaj me rastin e aplikimit kërkohet deklarata për shëmangien e financimit të dyfishtë;
- Të kenë dorëzuar një projekt propozim sipas formularit e aplikacionit të projektit/programit së bashku me formularin e propozim buxhetit.

Gjatë vlerësimit dhe përcaktimit të këtyre kritereve, Komisioni vlerësues u pajtua që tridhjetë e gjashtë (36) projekt-propozime të diskualifikohen.

#### Kriteret e veçanta:

Në mënyrë që aplikacioni të konsiderohet i kompletuar, aplikuesi duhet të plotësoj edhe kriteret e veçanta minimale të parapara me dispozitat në vijim:

- Të dorëzoj brenda afatit të thirrjes projekt propozimin i cili ndër të tjera përmban të dhënat pér qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të dhënrat tjera sipas formularit përkatës të përcaktuar sipas thirrjes publike.
- Projekt propozimi të jetë i shoqëruar me një propozim buxhet, sipas formatit të përcaktuar sipas thirrjes publike.
- Të dorëzojë të dhëna pér personelin kyç, duke specifikuar detyrat e tyre, siguruar CV-të e tyre së bashku me një deklaratë pranimi nga ana e tyre se do të punojnë pér projektin/programin, në rast të përfitimit të mbështetjes financiare, nëse kjo është e domosdoshme sipas thirrjes.
- Të sigurojnë dëshmitë e duhura pér projektet pér të cilat kërkohet bashkëfinancim, nëse është e aplikueshme.
- Të dëshmojnë se kanë pérvojë në realizimin e projekteve/programeve të ngjashme duke siguruar dëshmi të realizimit të projekteve të ngjashme në të kaluarën, nëse kjo është e domosdoshme sipas thirrjes përkatëse.
- Të paraqesin leje/licencë pér ushtrimin e veprimtarisë në rastet kur me legjislacionin në fuqi ushtrimi i një veprimtarie të tillë mund të kryhet vetëm me leje/licencë nga autoritetet publike.

Nga kjo, Komisioni ka konstatuar se nga gjithsejtë gjashtëdhjetë e e tetë (68) projekt-propozime të OJQ-ve që i kanë plotësuar kriteret e përgjithshme dhe rrjedhimisht kanë kaluar në fazën e dytë të vlerësimit, janë tridhjetë e dy (32) të cilat i plotësojnë edhe kriteret e veçanta pér t'u kualifikuar si përfituese të financimit nga MZHR.

Pjesë e vendimit është edhe raporti i Komisionit pér OJQ-të përfituese të listës preliminare, i cili është shpallur në ueb faqen zyrtare të MZHR-së me datë 18.03.2021.


#### Komisioni i vlerësimit të projekt-propozimeve të OJQ-ve:

Nënshkrimi i anëtarëve të Komisionit:

1. Arta Maloku – Kryesuese: 

2. Arbnor Sadiku – anëtar: 

3. Adis Salaji – anëtar: 

4. Adnan Sogojeva – anëtar: 

5. Fehmi Ramadani – anëtar: 

6. Kenan Gashi – ekspert i jashtëm/ monitorues: 